



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Tabela paraprake e vlerësimit të fakteve/vlerësimit nga monitorimi		Datë: 22.11.2018	(dy). 1 seancë dëgjimore + 1 seancë dhënie vendimi
<i>Ky monitorim u realizua në kuadër të projektit nr.2 "Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut" – projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqipëri (OSFA) dhe zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH).</i>			
A. Informacioni bazë			
Institucioni dhe tema:	Institucioni: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (këtu e më poshtë KPK). Objekti: Procesi i Vettingut të subjektit të rivlerësimit z. Artur Selmani.		
Emri i subjektit të rivlerësimit	z. Artur Selmani.		
Pozicioni i punës/ qyteti nëse nuk është Tirana	Prokuror, në Prokurorinë e Përgjithshme.		
A u shty seanca dhe a ishte e arsyeshme kjo shtyrje?	Seanca u zhvillua e plotë, në intervalin kohor 12:00-13:32. Trupa gjyqese e KPK u tërhoq për të marrë vendimin, duke shtyrë seancën për 4 ditë (dt. 26 nëntor).		
A u shpall vendimi apo jo (Ju lutem paraqisni arsyet në mënyrë të përmbledhur)	Shpallja e vendimit është shtyrë për dt. 26 nëntor, ora 11:00.		
B. Aktorët që marrin pjesë në proces/seanca			
Tupa gjyqese (emrat)	Roland Ilia - Kryetar i trupit gjyqes; Eteda Ciftja - Relatore e çështjes; Firdes Shuli - anëtare e trupit gjyqes; Të pranishëm pa shkëputje gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.		
Monitoruesit ndërkombëtarë (emrat)	Në cilësinë e vëzhguesit ndërkombëtar paraqitet, znj. Mia Rosien. E pranishme pa shkëputje gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.		
Mbrojtje me avokat apo mbrojtje personalisht (specifikoni)	Mbrojtja u realizua personalisht.		
Monitoruesi/ja i/e KSHH:	Albana Misja		
Anëtarë të tjerë të publikut të pranishëm?	Numri i anëtarëve nga publiku konstatohet të jetë rreth 30 persona, pavarësisht masave të sigurisë, me akses të plotë në hyrjen e godinës dhe pjesëmarrje fizike në seancën dëgjimore. Akomodimi u krye në formë të rregullt nga stafi menaxhues i KPK.		
Media e pranishme:	Mediat lokale ishin të pranishme, me përfaqësues, me akses të plotë në hyrjen e godinës.		
C. A vendosi institucioni i vettingut ta bëjë vettingun për të tre kriteret apo bazuar vetëm në një apo dy prej tyre?	Po/Jo	Nëse po, si u justifikua ai?	Nëse po, si ka reaguar subjekti ndaj kësaj ?
	Po	Trupa gjyqese vendosi të përfundoj hetimin administrativ kryesisht dhe të paraqesë rezultat e tij për të tre kriteret e rivlerësimit: vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale dhe etike.	Subjekti i rivlerësimit replikoj dhe kundërshtoj përfundimet e hetimit administrativ për të treja kriteret e vlerësimit.
D. Përmbajtja e çështjes (Vlerësimi i kriterëve)	Argumenti	kush e ka dhënë argumentin	A u diskutua? Prova? A u kalua barra e provës ?
	Referuar të dhënave në Raportin Vlerësues të ILDKPKI dorëzuar pranë Komisionit, në lidhje me subjektin e rivlerësimit konstatohet se: Deklarimi nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin; ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka kryer deklarim të rremë dhe subjekti nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit.	Të dhëna nga raportet e ILDKPKI	Provata e administruara nga Komisioni lidhur me Vlerësimin e pasurisë: Dokumentacioni i administruar në dosjen ILDKPKI, provat e dorëzuara

D1. Pasuria	<p>Komisioni kreu hetim të pavarur administrativ mbi verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit. Rezultatet e hetimit për këto pasuri: 1- Apartament banimi, Tiranë, përfutur me k.shitje 1999, cmimi është likuiduar me anë të kredisë nga Banka e Kursimeve sipas VKM 1999 për trajtimin me strehim të funksionarëve shtetëror, cmimi i blerjes 4 milion lek, në bashkëpronësi me bashkëshorten, pjesë takuese 50%. burimi i krijimit: k.e huasë me palën huadhënëse. Nga hetimi komisioni konstatohet se ka mospërputhje deklarimesh në lidhje me sipërfaqen e kësaj banese,dhe nuk provohet me dokumentacion justifikues ligjor kalimi i shumës prej 4 milion lekësh që kanë shërbyer për këtë blerje. Gjithashtu nga analiza financiare KPK konstatoi se ka mungesë të burimeve financiare në shumën 65, 541 lek. 2-Depozitë bankare pranë Reifeisen bank, në shumën 2,5 milion lek. burim krijimi: kursimet ndër vite. Përfundimisht nga hetimi Komisioni deklarohet se subjekti nuk provon me dokumentacion justifikues ligjor shumat që kanë kontribuar në krijimin e këtyre llogarive. Subjekti ka deklaruar se të ardhurat i ka përfutur nga llotaritë sportive 2006-2008 dhe nga dhurimet nga e motra, të cilat nuk justifikohen me dokumentacion justifikues ligjor, si dhe as të ardhurat e ligjshme që kanë shërbyer si burim për dhuratat e dhëna. Përfundimisht konstatohet nga KPK se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme dhe dokumentacion justifikues ligjor, në shumën totale rreth 3, 820,000 lek.</p>	Relatori	nga subjekti në përgjigje të pyetësorëve drejtuar nga Komisioni, të dhëna marrë nga institucionet shtetërore, prova shkresore nga subjektet private, deklaratat e subjektit, raport nga këshilltari financiar, denoncime nga publiku, fakte të njohura botërisht me burim median.
	nuk ka	Mbrojtja	
	<p>Subjekti i rivlerësimit prapëson: Lidhur me konstatimet e pasurive, nënvizon përfundimet e marra nga eksperti i pavarur, se pasuria e tij justifikohet nga burimet e të ardhurave. Sipas subjektit: nuk janë marrë parasys nga Komisioni në llogaritjet që ka kryer: vlera 800.000 lek përfutur nga shitja e pasurive të caktuara; vlera 900.000 lek përfutur nga revista Gaius; si dhe të ardhurat nga pensioni i nënës. Subjekti prapëson gjithashtu, në lidhje me dokumentat justifikues të kërkuar nga KPK, cilat janë ato dhe cilat janë pasojat e pasurive që rezultojnë të ligjshme por që nuk mund të justifikohen me dokumenta justifikues (sic mund të jenë dhuratat). Lidhur me këto subjekti pretendon paqartësi ligjore se cilat dokumente mund të justifikojnë ligjërisht një dhurim. Subjekti referon në Kushtetutë, e cila përcakton, në favor të subjektit të rivlerësimit, se diferenca e pasurisë së justifikuar dhe asaj të ligjshme por të pajustificuar nuk duhet të kalojë dyfishin. Lidhur me diferencën në sipërfaqen e apartamentit, ngritur si shqetësim nga KPK, arsyetohet se ka pasur metoda të ndryshme të përlllogaritjes në atë kohë, ku përfshiheshin sipërfaqet e përbashkëta. Referuar transaksioneve të kryera, pas verifikimeve personale të bëra me shoqërinë e pretenduar nga KPK, rezulohet se vetë shoqëria referon se transaksioni në fjalë ekziston në emrin e subjektit por jo në ID e tij.</p>	Subjekti i rivlerësimit	
		Ankesa nga publiku	
	Perfaqësuesi i ONM		
D2. Figura /Kontaktet me krimin e organizuar	<p>Të dhënat nga raporti sekret i DSIK, në përputhje me N.39 të ligjit 84/2016 dhe Nenit DH të aneksit të Kushtetutës, konstatojnë vlerësimin: "I Papërshtatshëm" për vazhdimin e zhvillimit të detyrës, për arsye se, citoj: " Në këndvështrimin e përgjithshëm të kontrollit të figurës së një funksionari publik me cilësinë e prokurorit, cdo dyshim i arsyeshëm për kryerje ose moskryerje të veprimeve në kundërshtim me ligjin në përmbyshje të rregullt të detyrës, dhe kur këto mos/veprime sjellin përfitime materiale ose jo, duke dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit apo personave të tjerë, këto çënojnë figurën e prokurorit, shkallën e besueshmërisë, dhe e bëjnë subjekt të mundshëm për tu vënë nën presion të strukturave kriminale"</p>	Të dhëna nga raportet e DSIK	Raporti Vlerësues i Drejtorisë së Sigurisë dhe Informacionit të Klasifikuar, Prova shkresore nga subjektet private, deklaratat e subjektit, Raport nga këshilltari financiar, denoncime nga publiku, fakte të njohura botërisht me burim median.
	<p>Komisioni kreu hetim administrativ mbi verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit, nëse ka bërë deklarime të pasakta, ose ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar sie dhe konstatohet se subjekti ka deklaruar se ka fituar të ardhura nga pjesëmarrja në llotari sportive.</p>	Relatori	
		Mbrojtja	
	<p>Subjekti i rivlerësimit deklarohet se nuk mund të arrijë DSIK në përfundimin e papërshtatshmërisë, duke e argumentuar vetëm me dyshim të arsyeshëm, mbi të gjitha pa përcaktuar në formë transparente cilat janë këto dyshime, pa dhënë asnjë deklaratë apo indicie, cilat janë këto shkelje në detyrë. Pra mungon në relacionin e DSIK, cilat janë dyshimet dhe baza ligjore. Lidhur me angazhimin në llotari sportive paraqet pendim, duke deklaruar se ka rreth 10 vjet që ka hequr dorë. Kjo nuk përcaktohet si sjellje etike, por jo e paligjshme. Elementi i paligjshmërisë i angazhimit në llotari sportive nuk referohet në asnjë bazë ligjore apo kod etike.</p>	Subjekti i rivlerësimit	
	Ankesa nga publiku		
	Perfaqësuesi i ONM		
	Në lidhje me komponentin e Vlerësimit të Figurës përfaqësuesja e ONM drejton pyetjen: Nëse subjekti i rivlerësimit gjykon që realisht ka hequr dorë nga vesi i angazhimit në llotari sportive apo jo?		

D3. Vlerësimi i aftësive profesionale dhe etikës	Të dhënat marrë nga Grupi I punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme: Në lidhje me aftësitë profesionale, aftësitë organizative, etikën dhe angazhimin profesional, dhe integritetin është vlerësuar "shume mirë".	Të dhëna nga Grupi I punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme	Provat e administruara në seancë dëgjimore: Raporti I vlerësimit të aftësive profesionale të Grupi I punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme; 5 dokumenta të zgjedhura me short, 3 dokumenta të përzgjedhura nga vetë subjekti; kallelime nga shtetasit; Prova shkresora nga subjektet private, deklaratat e subjektit, Raport nga këshilltari financiar, denoncime nga publiku, fakte të njohura botërisht me burim median.
	Hetimi i komisionit konsiston në faktin nëse subjekti ka njohuri, aftësi apo gjykim të cekët. Komisioni konstatohet se është publikuar në media ankesa e familjarëve të disa viktimave përfshirë në një procedim penal, duke pretenduar se subjekti i rivlerësimit dhe prokurorët e tjerë të Prokurorisë së Përgjithshme, kanë mbajtur qëndrime të ndryshme nga prokurorët e shk. së parë dhe të Apelit Vlorë, duke lehtësuar akuzat ndaj të pandehurve. Për këtë ngjarje Prokurori i Përgjithshëm ka vendosur pezullimin nga detyra, deri në përfundimin e hetimeve të këtij procedimi. Komisioni e gjykon këtë urdher pezullimi si masë disiplinore, duke iu referuar N. 110 të ligjit 96/2016. Gjithashtu sipas KPK konstatohet se subjekti ka thënie kontradiktore me deklaratimet e eprrorit të tij në lidhje me dakordësimin, për qëndrimin që do të mbanin në Gjykatën e Lartë lidhur me një çështje në procedim. Vec kësaj Komisioni konstaton, lidhur me disa procedime penale të udhëhequra nga subjekti i rivlerësimit, citoj"duket se, me sjelljet dhe qëndrimet e marra për këto vepra dhe akuza, Subjekti nuk ka respektuar të drejtat e viktimave"	Relatori	
	nuk ka	Mbrojtja	
	Subjekti i rivlerësimit deklarohet se Urdhri I pezullimit të P.P.nuk ka qenë masë disiplinore (pasi referon qartësisht se pezullimi zgjat vetem deri në përfundimin e hetimit të çështjes në fjalë), dhe nuk duhet parë nën frymën e N. 110 të ligjit sic referon Komisioni, por të N. 151 të tij. Gjithashtu subjekti ndalon tek argumenti i dhënë nga drejtoresha se prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme nuk duhet të dalin në qëndrime të kundërta me ato të prokurorëve të shkallëve të ulta. Edhe sikur të ishte vlerësim jo ligjor, sipas subjektit, nuk duhet të përkthehet kundërshtimi i pikëpamjeve të eprrorit me paaftësinë profesionale.	Subjekti i rivlerësimit	
nuk ka	Ankesa nga publiku Perfaqësuesi i ONM		
E.Konkluzione dhe komente të monitoruesit të KSHH (Vlerësimi paraprak i monitoruesit të KSHH për aspektet e procesit të drejtë ligjor (publiciteti, etika e organeve të vettingut dhe përfaqësuesit të OMN , si e vlerësoni hetimin administrativ, të drejtat e mbrojtjes së subjektit, barazia e mjeteve ligjore, parimi i kontradiktoritetit, koha e arsyeshme, e drejta për të paraqitur prova dhe e drejta për tu dëgjuar, etj.)	Aksesi i pjesëmarrjes është respektuar. Etika e sjelljes së trupit gjykues është e rregullt dhe të folurit të kuptueshëm. Pas celjes së seancës dëgjimore, referuar nenit 55 të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar", prezantohet trupa gjykuese, i jepet mundësia subjektit të rivlerësimit të referoj publikisht gjeneralitetet dhe funksionin përkatës për identifikim dhe prezantohet nga kryesuesja e trupit gjykues nje parashtrim i shkurtër i procedurës së seancës dëgjimore. Deklarohen nga relatori i ceshtjes dhe konfirmohen nga subjekti respektimi i te drejtave të tij proceduriale si: është njoftuar për procedurën e fillimit të rivlerësimit dhe përbërjen e trupës gjykuese, për të cilët nuk ka pasur deklarim për konflikt interesi. është njohur me dokumentat e dosjes dhe të drejtat e saj në përputhje me K.Pr. A. I janë dhënë disa ditë kohë për tu njohur me dosjen, dhe për të disponuar kopje të saj, si dhe iu bënë të ditura rezultatet e hetimit administrativ më 2 nëntor. Më 19 nëntor subjekti paraqiti qëndrimin e saj me shkrim. I rezervohet e drejta përfaqësuesit të Operacionit Ndërkombetar të Monitorimit, dhe trupit gjykues të drejtojnë pyetje, dhe iu dha mundësia e fjalës në seancë dëgjimore subjektit të rivlerësimit.Kohëzgjatja e seancës degjimore është e arsyeshme (1 orë 32 minuta), duke marrë parasysh se kohën më të madhe e morën parashtrimet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues tërhoqet për shpalljen e dispozitivit të vendimit, duke shtyrë seancën për 4 ditë. Sa më sipër, seanca dëgjimore e subjektit të rivlerësimit z. Enton Dhimitri, plotëson kriteret që referon ligji nr 84/2016, Kodi i Procedurës Administrative (Nenet 45-47) dhe Aneksi shtojcë i Kushtetutës, referuar te drejtave proceduriale dhe respektimit të elementeve përbërës të procesit të rregullt ligjor, mbrojtjes efektive, aksesit në gjykim, kohëzgjatjes së arsyeshme të seancës. Lidhur me administrimin e provave, Komisioni nuk duhet të marre atributet e gjykatës duke u shprehur se: citoj"duket se, me sjelljet dhe qëndrimet e marra për këto vepra dhe akuza, Subjekti nuk ka respektuar të drejtat e viktimave". Gjithashtu, në aspektin ligjor, qëndrimi iKomisionit lidhur me vlerësimin e aftësisë, se prokurorët e përgjithshëm nuk duhet të dalin me qëndrime të kundërta me ata të prokurorëve me të ulta, është proceduralisht i gabuar.		